



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____, Prot.

Tiranë, më _____. _____. 2021

VENDIM
Nr. 540, datë 17.11.2021

PËR
CAKTIMIN E GJYQTARËVE PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE TË
VEÇANTA NË GJYKATA TË TJERA, TË NDRYSHME NGA AJO KU USHTROJNË
FUNKSIONET NË MËNYRË TË PËRHERSHME

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenet 4/3, 147/1, 147/a, pika 1 germa “a” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 2, 89 e 97/3 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, në nenin 170/1 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në vendimin nr.30, datë 14.02.2019 të Këshillit të Lartë të Gjyqësor që miratoi projektvendimin “Për rregullat dhe procedurat e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme” i ndryshuar, në rastet kur skema e delegimit dhe transferimi i përkohshëm janë të pamjaftueshme për t’iu përgjigjur nevojave aktuale të gjykatave, pasi shqyrtoi relacionet dhe propozimin e Komisionit për Zhvillimin e Karrierës si dhe organizoi shortin, në përfundim të tij,

VENDOSI:

I. Të caktojë gjyqtarët për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykatat në nevojë si vijon:

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR LEZHË

1. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, Olti Skrame, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Neni 78/2 e 25 i Kodit Penal”.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR TROPOJË

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, Merita Karaj, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, çështjen gjyqësore me Kërkues: Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tropojë; Objekti: “Kërkesë për dërgimin në gjyq të procedimit penal me nr.143 të vitit 2020, në ngarkim të të pandehurit {...}i akuzuar për kryerjen e veprës penale të “Kanosja”, e parashikuar nga neni 84 i Kodit Penal”.

GJYKATA E APELIT DURRËS

1. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Shkodër, Tonin Sterkaj, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Durrës, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: Për veprën penale të parashikuar nga nenet 79/dh-22-25 të Kodit Penal.

GJYKATA E APELIT GJIROKASTËR

1. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Vlorë, Laurent Fuçia, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, çështjen civile me Paditës: {...}; I paditur: {...}; Objekti: “Kthim shume, sigurim padie, etj.”
2. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Vlorë, Engert Pëllumbi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, çështjen civile me Paditës: {...}; I paditur: {...}; Objekti: “Dhënie autorizimi për të dalë jashtë shtetit për fëmijët e mitur”.
3. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Vlorë, Iliba Bezati, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, çështjen penale me Të pandehur: {...}, {...}, etj.; Objekti: “Dërgim në gjyq”.

GJYKATA E APELIT SHKODËR

1. Gjyqtaret e Gjykatës së Apelit Durrës, Irida Kacerja dhe Igerta Hysi, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Shkodër, çështjen gjyqësore me Kërkues: {...}; Objekti: “Plotësim vendimi”.
2. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Durrës, Anita Mici, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Shkodër, çështjen civile me Paditës: {...}; E paditur: {...}; Objekti: “Krijim servituti”.

GJYKATA E APELIT TIRANË

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Korçë, Sonjela Voskopi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Tiranë, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor”.

GJYKATA E APELIT VLORË

1. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, Sokol Pina, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Vlorë, çështjen gjyqësore me Kërkues: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Fier; Të pandehur: {...}, etj.; Akuza: “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”.
2. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, Irena Brahimi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Vlorë, çështjen gjyqësore me Ankues: {...} Kundër: Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier; Objekti: “Ankim kundër vendimit nr.24 prot., datë 05.02.2021 të prokurorit për mosfillimin e kallëzimit penal nr.45, datë 12.01.2021”.
3. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, Enton Dhimitri, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Vlorë, çështjen gjyqësore me Ankues: {...}; Kundër: {...}; Objekti: “Shfuqizim i vendimit datë 04.12.2020 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnje “Për mosfillimin e procedimit penal për kallëzimin nr.1167 viti 2020”, regjistrimin e këtij procedimi dhe kthimin e çështjes për hetime të mëtejshme pranë kësaj prokurorie”.

- II. Një kopje e vendimit t’i njoftohet kryetarit të gjykatës në nevojë dhe gjyqtarëve përkatës të caktuar për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në një gjykatë tjetër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR